



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 19

27 shkurt

2013

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr. 89, datë 16.1.2013	Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2013..... 767
Vendim i KM nr. 91, datë 6.2.2013	Për miratimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, e Shoqatës Rajonale për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta, Korçë (KRWM) dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e masave shoqëruese të projektit “Menaxhimi i mbetjeve të ngurta në Shqipërinë Juglindore”..... 769
Vendim i KM nr. 92, datë 6.2.2013	Për hapjen e pikës së përbashkët të kalimit ndërkuftar në Trebisht të rrethit të Bulqizës, në kufirin shtetëror tokësor të Republikës së Shqipërisë me Maqedoninë..... 773
Vendim i KM nr. 93, datë 6.2.2013	Për hapjen e pikës së përbashkët të kalimit kuftar në Grabon të rrethit të Malësisë së Madhe dhe të pikës së kalimit ndërkuftar në Çerem të rrethit të Tropojës, në kufirin shtetëror tokësor të Republikës së Shqipërisë me Malin e Zi..... 774
Vendim i KM nr. 94, datë 6.2.2013	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Gosë të qarkut të Tiranës..... 775
Vendim i KM nr. 95, datë 6.2.2013	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Karinë të qarkut të Elbasanit..... 776
Vendim i KM nr. 96, datë 6.2.2013	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Brendshme, për programin e Shërbimit të Gjendjes Civile, për mbulimin e shpenzimeve të printimit të listave të zgjedhësve..... 777
Vendim i KM nr. 97, datë 6.2.2013	Për një ndryshim në vendimin nr. 484, datë 23.6.2010 të Këshillit të Ministrave “Për emërimin e anëtarëve të bordit të menaxhimit për Autoritetin Rrugor Shqiptar”..... 784

Vendim i KM nr. 100, datë 6.2.2013	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Ura e Re e Bunës (shatesat)”	784
Vendim i KM nr. 101, datë 6.2.2013	Për një shtesë në vendimin nr. 424, datë 2.6.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë”, të ndryshuar.....	785
Vendim i KM nr. 103, datë 6.2.2013	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e shpenzimeve të kurimit të znj. Mesila Doda.....	786
Udhëzim i MPÇSSHB nr. 1, datë 7.2.2013	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 1457, datë 28.7.2009 “Për procedurën e shqyrtimit të kërkesave për licencim, të subjekteve që kryejnë veprimtari të formimit profesional”, të ndryshuar.....	787
Urdhër i MF nr. 9, datë 13.2.2013	Për revokimin e urdhrit të Ministrit të Financave nr. 6, datë 25.11.2005 “Për sekuestrimin e aseteve të shtetasit jordanëz Abdul Latif Saleh, i njohur edhe si: a) Abdyl Latif A.A.Saleh, b) Abdyl Latif Saleh, c) dr. Abd Al-Latif Saleh, d) Abdyl Latif A.A.Saleh Abu Hussein, e) Abd Al-Latif Salih, f) Abu Amir”, i ndryshuar.....	788
Vendim i ERE nr. 17, datë 31.1.2013	Mbi shtyrjen e ankandit vjetor të kapaciteteve të interkonjeksionit për vitin 2013.....	789
Vendim i ERE nr. 18, datë 11.2.2013	Për miratimin e disa ndryshimeve në Rregullat e Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike.....	789
Vendim i ERE nr. 19, datë 11.2.2013	Për kualifikimin e impiantit prodhues për hecet “Verba 1” dhe “Verba 2” të shoqërisë “Hydro Power Plant of Korca” sh.p.k. si burim i rinovueshëm energjie.....	790
Vendim i ERE nr. 20, datë 11.2.2013	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për modifikimin e licencës me nr. 10, seria PV03P për prodhimin e energjisë elektrike nga hec “Bicaj” me fuqi 100 kW të shoqërisë “EN.KU” sh.p.k.....	791
Vendim i KKRT nr. 16, datë 18.1.2013	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Top Gold”.....	792
Vendim i KKRT nr. 26, datë 18.1.2013	Mbi vlefshmërinë e licencës së subjektit televiziv kabllor “Tv me kabëll Memaliaj”.....	792
Vendim i KKRT nr. 36, datë 1.2.2013	Për dhënie licence për televizionin privat kabllor “Tv Next Kabëll”.....	794
Vendim i KKRT nr. 37, datë 1.2.2013	Për zgjerim zone licencimi për radion vendore private “Radio Durrësi”.....	794
Vendim i KKRT nr. 38, datë 1.2.2013	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Alpo”.....	795
Vendim i KKRT nr. 39, datë 1.2.2013	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Nacional”.....	795

VENDIM
Nr. 89, datë 16.1.2013

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE BAZË TË SEKTORËVE QË DO TË MBËSHTETEN
DHE TË MASËS SË PËRFITIMIT NGA FONDI I PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE
ZHVILLIMIN RURAL, PËR VITIN 2013**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 6 të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural” dhe të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondet e miratuara në buxhetin e vitit 2013 për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, zëri “Transferte në buxhetet familjare”, të përdoren për mbështetjen e prodhimit bujqësor, blegtoral dhe të agropërpunimit.

2. Fondet e transfertës së pakushtëzuar, që do të përdoren për pemëtari, sipas ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, do t’i bashkëngjiten këtij fondi dhe për këto fonde do të ndiqen të gjitha procedurat e vlerësimit, të përcaktuara për këtë qëllim në udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

3. Sektorët që do të mbështeten nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural janë:

- a) Prodhimi i frutave, arrorëve, shegës dhe ullinjve;
- b) Prodhimi i perimeve në serra;
- c) Prodhimi i qumështit, vajit të ullirit dhe mjaltit;
- ç) Përmirësimi racor në blegtori;
- d) Prodhimi i produkteve organike;
- dh) Nxitja e kreditimit bankar në sektorin e bujqësisë;
- e) Nxitja e kooperimit bujqësor;
- ë) Mbarështimi i kërmillit;
- f) Prodhimi dhe grumbullimi i bimëve medicinave.

4. Masat e mbështetjes dhe masa e përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, në shkallë vendi, të jenë, si më poshtë vijon:

4.1 Për mbjellje ullishtash, në vlerën 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha, për format intensive të kultivimit dhe në vlerën 180 000 (njëqind e tetëdhjetë mijë) lekë/ha, për format tradicionale.

4.2 Për mbjellje arrash, në vlerën 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha, për mbjelljet me fidanë të shartuar dhe në vlerën 180 000 (njëqind e tetëdhjetë mijë) lekë/ha, për mbjelljet me fidanë të pashartuar në të gjithë vendin.

4.3 Për mbjellje ekstensive lajthish dhe shegësh, në vlerën 180 000 (njëqind e tetëdhjetë mijë) lekë/ha.

4.4 Për mbjellje ekstensive lajthish dhe shegësh, në vlerën 200 000 (dyqind mijë) lekë/ha.

4.5 Për mbjellje mollësh, dardhash, kumbullash, qershish, pjeshkash dhe ftonjsh, në vlerën 200 000 (dyqind mijë) lekë/ha.

4.6 Për mbjellje agrumesh, kivi dhe luleshtrydhes, në vlerën 200 000 (dyqind mijë) lekë/ha, për format intensive të kultivimit.

4.7 Për mbjelljen e vreshtave, në vlerën 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha.

4.8 Për ujitjen me pika në arrorët, lajthitë, bajamet e shegën, pemëtoret, agrumishtet, ullishtet (vetëm për format intensive të kultivimit të tyre) dhe serrat me ngrohje diellore dhe teknike,



në vlerën 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha. Sipërfaqja minimale të jetë jo më pak se 5 (pesë) dynymë.

4.9 Për prodhimin e vajit të ullirit extra i virgjër, në vlerën 100 (njëqind) lekë/litri, për sasitë e prodhimit deri në 15 (pesëmbëdhjetë) tonë/viti.

4.10 Për prodhimin e produkteve organike bujqësore nga bimët e kultivuara, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë/ferma.

4.11 Për blerjen ose zëvendësimin e plastmasës për serrat me ngrohje diellore dhe teknike (në shkallë vendi), në vlerën 400 000 (katërqind mijë) lekë/ha. Sipërfaqja minimale të jetë 2 (dy) dynymë.

4.12 Për blerjen e plastmasës për prodhimin e bostanoreve në tunele, në vlerën 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha, për fermerët që mbjellin jo më pak se 5 (pesë) dynymë bostanore.

4.13 Në vlerën 10 (dhjetë) lekë/litri qumësht, për fermat blegtorale që mbarështojnë jo më pak se 10 (dhjetë) krerë lopë qumështi të matrikulluara të racave të pastra apo kryqëzimet e tyre, por financimi të bëhet për jo më shumë se 80 (tetëdhjetë) krerë. Pagesa të bëhet kundrejt sasive të qumështit, të deklaruara në organet tatimore.

4.14 Në vlerën 500 (pesëqind) lekë/krerë dele ose dhi të matrikulluara për fermerët, të cilët mbarështojnë jo më pak se 100 (njëqind) krerë, por financimi të bëhet për jo më shumë se 300 (treqind) krerë.

4.15 Në vlerën 5 000 (pesë mijë) lekë/krerë dele ose dhi race e pastër që mbarështojnë mbi 10 (dhjetë) krerë, por financimi të bëhet për jo më shumë se 50 (pesëdhjetë) krerë.

4.16 Në vlerën 5 000 (pesë mijë) lekë/krerë për viçat për majmëri për fermat që mbarështojnë mbi 10 (dhjetë) krerë, por financimi të bëhet për jo më shumë se 50 (pesëdhjetë) krerë.

4.17 Në vlerën 600 (gjashtëqind) lekë/koshere blete për fermerët me jo më pak se 50 (pesëdhjetë) koshere blete.

4.18 Në vlerën 20 000 (njëzet mijë) lekë për kokë mëshqerre, racë e pastër, të moshës mbi 15 (pesëmbëdhjetë) muaj në zona të caktuara, ku ekziston përqendrimi më i madh i gjedhit për fermat ose grup fermash blegtorale që prodhojnë jo më pak se 3 (tri) mëshqerra, por financimi të bëhet për jo më shumë se 50 (pesëdhjetë) krerë.

4.19 Mbështetja, përmes subvencionit, në masën 70% të normës së interesit, për 5 (pesë) vite radhazi, për kreditë deri në 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekë, që do të merren për aktivitetet e mëposhtme:

a) Ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore, blegtorale, kërpuhës dhe bimëve medicinave;

b) Mjetet mekanike bujqësore, agregate dhe tank ftohës për qumështin;

c) Peshkimin dhe përpunimin e produkteve ujore;

ç) Veprimtaritë në agro dhe ekoturizëm.

4.20 Për grumbullimin e gështenjës, boronicës dhe shegës, në vlerën 1 200 (një mijë e dyqind) lekë/kv. Pagesa të bëhet vetëm kundrejt sasive të gështenjave, të boronicave dhe të shegëve të shitura me faturë tatimore.

4.21 Për mbarështimin intensiv të kërmillit, në masën 50% të vlerës së rasatit për ha, por jo më shumë se 500 000 (pesëqind mijë) lekë/ha.

Kjo mbështetje të jetë për ata që fillojnë investimin për mbarështimin e kërmillit për herë të parë. Për mbarështuesit që e kanë bërë investimin fillestar më parë, të vihet mbështetje e fermave që bëjnë mbarështimin intensiv të kërmillit, me një vlerë 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha.

4.22 Për mbjellje të bimëve medicinave të kultivuara, si: sherebelë, lavanda, timus, rigon dhe rozmarinë, në bllok e sipas zonave të përcaktuara më parë për kultivim, në masën 50% të kostos totale të projektit, por jo më shumë se 200 000 (dyqind mijë) lekë/ha.

4.23 Për mbështetjen e shoqërive të bashkëpunimit bujqësor për projekte për ngritje ambientesh për ruajtje të prodhimit, linja për standardizim prodhimi dhe mekanikë bujqësore, të financohet deri në masën 50% të projektit, por jo më shumë se 5 000 000 (pesë milionë) për një subjekt (SHBB).

5. Sipërfaqja minimale e mbjellë me bimët e përshkruara në nënpikat 4.1, 4.2, 4.3, 4.4, 4.5, 4.6 e 4.7 të pikës 4, duhet të jetë jo më pak se 2 (dy) dynymë.

6. Projektet e vlerësuara dhe të papaguara gjatë vitit 2012, për mbjelljen e arrorëve, shegëve, subtropikaleve, ullinjve, pemëve frutore, vreshtave dhe bimëve medicinave, që plotësojnë kushtet për pagesë, të financohen nga fondet e planifikuara të vitit 2013, sipas pagesave të përcaktuara në këtë vendim.

7. Në komisionin e vlerësimit të projekteve për skemat mbështetëse të pemëtarisë do të marrë pjesë një përfaqësues i pushtetit vendor.

8. Një vlerë prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh do të përdoret për bashkëfinancim me projektin e IPA-së 2011 “Mbështetje për bujqësinë dhe zhvillimin rural”.

9. Për informimin mediatik të publikut, lidhur me masat e mbështetjes nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2013, të përdoret nga ky fond vlera prej 5 000 000 (pesë milionë) lekësh.

10. Kriteret, procedura dhe mënyra e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural përcaktohen në udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

11. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 91, datë 6.2.2013

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE, E SHOQATËS RAJONALE PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE TË NGURTA, KORÇË (KRWM) DHE KFW FRANKFURT AM MAIN, PËR FINANCIMIN E MASAVE SHOQËRUESE TË PROJEKTIT “MENAXHIMI I MBETJEVE TË NGURTA NË SHQIPËRINË JUGLINDORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, e Shoqatës Rajonale për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta, Korçë (KRWM) dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e masave shoqëruuese të projektit “Menaxhimi i mbetjeve të ngurta në Shqipërinë Juglindore”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



MARRËVESHJE FINANCIMI

NDËRMJET KFW, FRANKFURT AM MAIN (KFW) DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE (MARRËSI) DHE KRWM, SHOQATA
RAJONALE E KORÇËS PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE (AGJENCIA E ZBATIMIT TË
PROJEKTIT) PËR 1,000,000.00 EURO - MASË SHOQËRUESE (2010 70 176) E PROJEKTIT TË
INVESTIMIT “MENAXHIMI I MBETJEVE TË NGURTA NË JUGLINDJE TË SHQIPËRISË”
(2008 65 170)

Mbi bazën e marrëveshjes së datës 19 korrik, 2011, ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale Gjermane dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunimin Financiar 2004, 2008, 2010 për Projektin e Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta në Juglindje të Shqipërisë (marrëveshje qeveritare), Marrësi, Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja lidhin marrëveshjen e mëposhtme të financimit:

Neni 1

Shuma dhe qëllimi i kontributit financiar

1.1 KfW-ja i jep Marrësit një kontribut financiar që nuk i kalon 1,000,000.00 euro.

Ky kontribut financiar nuk është i shlyeshëm, përveç kur parashikohet ndryshe në nenin 4.2.

1.2 Marrësi e përdor kontributin financiar ekskluzivisht për shërbimet e ekspertëve mbi masat shoqëruese për fazën e dytë të zbatimit të projektit të investimit (Menaxhimi i Mbetjeve të Ngurta në Juglindje të Shqipërisë (shërbime eksperti)) dhe, kryesisht, për të paguar koston e shkëmbimit të huaj. Agjencia e zbatimit të projektit dhe KfW-ja përcaktojnë hollësitë e projektit dhe objektin e shërbimeve të ekspertëve që do të financohen nga kontributi financiar me marrëveshje të veçantë, e cila duhet të bihet dakord me Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit.

1.3 Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja përcaktojnë me hollësi kontributet homologe të kontributit financiar, sipas rastit, që duhet të jepen nga agjencia e zbatimit të projektit, në një marrëveshje të veçantë. Agjencia e zbatimit të projektit i jep kontributet e saj homologe të plota dhe në kohën e duhur. Agjencia e zbatimit të projektit, me kërkesë, i jep KfW-së prova që provojnë masat e marra për këtë qëllim.

1.4 Tatimet dhe detyrimet e tjera publike që duhet të mbulohen nga marrësi ose agjencia e zbatimit të projektit dhe detyrimet e importit nuk financohen nga kontributi financiar.

Neni 2

Kanalizimi i kontributit financiar tek agjencia e zbatimit të projektit

2.1 Marrësi e kanalizon kontributin financiar tek agjencia e zbatimit të projektit si një grant të pashlyeshëm në bazë të një marrëveshjeje të veçantë financimi.

2.2 Para disbursimit të parë nga kontributi financiar, marrësi i dërgon KfW-së një kopje dhe përkthim të vërtetuar të marrëveshjes së veçantë të financimit të përcaktuar në nenin 2.1.

2.3 Kanalizimi i kontributit financiar nuk përbën detyrim të agjencisë së zbatimit të projektit kundrejt KfW-së për detyrimet e pagesës sipas kësaj marrëveshjeje.

Neni 3

Disbursimi

3.1 KfW-ja e disburson kontributin financiar në pajtim me progresin e shërbimeve të ekspertëve dhe me kërkesë të agjencisë së zbatimit të projektit. Me marrëveshje të veçantë, agjencia e zbatimit të projektit dhe KfW-ja përcaktojnë për procedurën e disbursimit, veçanërisht për provat e

vërtetimit që fondet e disbursuara janë përdorur për këtë qëllim të parashikuar. Marrëveshja e veçantë duhet të miratohet nga Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.

3.2 KfW-ja ka të drejtën e refuzimit të bërjes së disbursimeve pas datës 31 dhjetor 2016.

Neni 4

Pezullimi i disbursimeve dhe shlyerja

4.1 KfW-ja nuk mund të pezullojë disbursimet, përveç kur:

a) Marrësi nuk përmbush detyrimet e tij kundrejt KfW-së për të bërë pagesat kur bëhen të kërkueshme;

b) detyrimet sipas kësaj marrëveshjeje ose sipas marrëveshjeve të veçanta që i përkasin kësaj marrëveshjeje, janë shkelur;

c) agjencia e zbatimit të projektit nuk është në gjendje të provojë që kontributi financiar është përdorur për qëllimin e parashikuar; ose

d) dalin rrethana të jashtëzakonshme që pengojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin ose qëllimin e shërbimeve të ekspertëve.

4.2 Nëse një nga situatat e përcaktuara në nenin 4.1b) dhe c) ka ndodhur dhe nuk është eliminuar brenda një periudhe të përcaktuar nga KfW-ja, që është të paktën 30 ditë, KfW-ja mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të kontributit financiar. Në rastin e përcaktuar në nenin 4.1 c), shlyerja kufizohet në ato shuma që agjencia e zbatimit të projektit nuk është në gjendje të provojë se janë përdorur për qëllimin e parashikuar.

Neni 5

Kostoja dhe detyrimet publike

Marrësi mbulon të gjitha tatimet dhe detyrimet e tjera publike që mblidhen jashtë Republikës Federale të Gjermanisë mbi lidhjen dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje, si dhe të gjitha kostot e transfertave dhe konvertimit që lindin në lidhje me disbursimin e kontributit financiar.

Neni 6

Deklarimet kontraktuale dhe prokura

6.1 Ministri i Financave dhe ata persona të caktuar prej tij ose saj për KfW-në dhe të autorizuar me modele nënshkrimesh të vërtetuara prej tij ose saj, përfaqësojnë marrësin në nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje. Administratori i Përgjithshëm i KRWM-së dhe ata persona të caktuar prej tij ose saj për KfW-në dhe të autorizuar me modele nënshkrimesh të certifikuara prej tij ose saj, përfaqësojnë agjencinë e zbatimit të projektit në nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje. Prokura nuk skadon derisa revokimi nga përfaqësuesi i autorizuar i marrësit për atë kohë të merret nga KfW-ja.

6.2 Ndryshimet ose shtesat e kësaj marrëveshjeje dhe çdo njoftim dhe deklaram i dhënë nga palët kontraktuese sipas kësaj marrëveshjeje bëhen me shkrim. Çdo njoftim ose deklaram i tillë quhet i marrë nëse mbërrin në adresën e mëposhtme të palës kontraktuese përkatëse ose në atë adresë tjetër të palës përkatëse kontraktuese që i njoftohet palës tjetër kontraktuese:

Për KfW-në:

KfW

LE a/4

Postfach 11 11 41

60046 Frankfurt am Main

Federal Republic of Germany

Faks: +49 69 7431-2944



Për marrësin:

Ministrisë së Financave
Bul. Dëshmorët e Kombit nr. 1
Tirana
Republika e Shqipërisë
Faks: +355 42 22 8494

Për agjencinë e zbatimit
të projektit:

KRWM
Rr. "Konferenca e Pezes"
Ish-shkolla "Th. Kavaloti" kati II, Korçë
Republika e Shqipërisë
Tel/faks: +355 822 481 86

Neni 7

Shërbimet e ekspertit

7.1 Agjencia e zbatimit të projektit:

a) përgatit dhe kryen shërbimet e ekspertëve në pajtim me praktikën e qëndrueshme financiare dhe inxhinierike dhe thelbësisht në pajtim me konceptimin e miratuar ndërmjet agjencisë së zbatimit të projektit dhe KfW-së për shërbimet e ekspertëve dhe, për këtë qëllim, përdor shërbimet e inxhinierëve të pavarur dhe të kualifikuar konsulentë;

b) mban ose merr masa për mbajtjen e librave dhe regjistrave që tregojnë qartë koston e shkaktuar në lidhje me shërbimet e ekspertëve dhe që identifikon qartë shërbimet e financuara nga kontributi financiar;

c) u mundëson përfaqësuesve të KfW-së në çdo kohë të inspektojnë këta libra dhe regjistra dhe çdo dokument tjetër në lidhje me zbatimin e shërbimeve të ekspertëve;

d) i jep KfW-së të gjithë informacionin dhe raportet mbi shërbimet e ekspertëve dhe përparimin e tyre të mëtejshëm, siç mund ta kërkojë KfW-ja; dhe

e) me iniciativë të vet, informon KfW-në për të gjitha rrethanat që përjashtojnë ose rrezikojnë seriozisht ekzekutimin e shërbimeve të ekspertëve ose qëllimin e tyre.

7.2 Marrësi dhe agjencia e zbatimit të projektit:

a) siguron financim të plotë të shërbimeve të ekspertëve dhe, me kërkesë, i jep prova KfW-së që provon që kostoja, e cila nuk paguhet nga ky kontribut financiar, të mbulohet; dhe

b) me iniciativë të tyre, njoftojnë menjëherë KfW-në për të gjitha rrethanat që pengojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e shërbimeve të ekspertëve.

7.3 Agjencia e zbatimit të projektit dhe KfW-ja përcaktojnë hollësitë në lidhje me nenin 7.1 në një marrëveshje të veçantë që duhet të miratohet nga Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.

Neni 8

Dispozita të ndryshme

8.1 Marrësi dhe agjencia e zbatimit të projektit sigurojnë që personat e ngarkuar nga agjencia e zbatimit të projektit me përgatitjen dhe zbatimin e shërbimeve të ekspertëve, dhënien e çdo kontrate për shërbimet e ekspertëve, që duhet të financohen dhe kërkimin e disbursimeve të shumave të kontributit financiar, të mos kërkojnë, prezumojnë, japin, dhurojnë, premtojnë ose përftojnë një premtim për pagesa të paligjshme dhe avantazhe të tjera në lidhje me këto detyra.

8.2 Agjencia e zbatimit të projektit i ofron KfW-së menjëherë me kërkesë të gjithë informacionin dhe dokumentet që KfW-ja kërkon për të përmbushur detyrimet e saj për të parandaluar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm

të marrëdhënieve të biznesit me marrësin dhe agjencinë e zbatimit të projektit, që është i nevojshëm për këtë qëllim.

Për lidhjen dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje, agjencia e zbatimit të projektit vepron në emrin e saj dhe për llogari të vet. Në lidhje me ligjin gjerman dhe ligjin e vendit të themelimit të agjencisë së zbatimit të projektit:

a) burimet e veta të agjencisë së zbatimit të projektit ose shumat e investuara në financimin e projektit nuk do të jenë me origjinë të paligjshme dhe, veçanërisht, kjo listë joshteruese, nuk lidhet me trafikimin e drogës, korrupsionin, aktivitetin e organizuar kriminal ose terrorizmin;

b) kapitali i aksionarëve të agjencisë së zbatimit të projektit nuk do të jetë me origjinë të paligjshme dhe, veçanërisht, kjo listë joshteruese, nuk lidhet me trafikimin e drogës, korrupsionin, aktivitetin e organizuar kriminal ose terrorizmin;

c) Agjencia e zbatimit të projektit nuk përfshihet në përfshimin, zotërimin ose përdorimin e pasurisë që është me origjinë të paligjshme dhe, veçanërisht, kjo listë joshteruese, nuk lidhet me trafikimin e drogës, korrupsionin, aktivitetin e organizuar kriminal ose terrorizmin; dhe

d) Agjencia e zbatimit të projektit nuk do të përfshihet në financimin e terrorizmit.

8.3 Nëse një prej dispozitave të kësaj marrëveshjeje është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera mbeten të pacenuara. Çdo boshllëk që rrjedh prej tij plotësohet me një dispozitë në pajtim me qëllimin e kësaj marrëveshjeje.

8.4 Marrësi dhe agjencia e zbatimit të projektit nuk mund të cedojnë, transferojnë, lënë peng ose rëndojnë me hipotekë asnjë pretendim të kësaj marrëveshjeje.

8.5 Kjo marrëveshje rregullohet nga ligji i Republikës Federale Gjermane. Vendi i përmbushjes është Frankfurt am Main.

8.6 Marrëdhëniet juridike ndërmjet KfW-së, marrësit dhe agjencisë së zbatimit të projektit të themeluar me këtë marrëveshje skadojnë gjashtë vjet pas disbursimit të fundit.

8.7 Kjo marrëveshje financimi nuk hyn në fuqi deri sa marrësi të njoftojë KfW-në me shkrim në lidhje me përmbushjen e procedurave të brendshme ligjore për marrëveshjen e financimit.

Bërë në 3 kopje origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main,	Tiranë,
më 2012,	më 2012
KFW	Republika e Shqipërisë
	përfaqësuar nga
	Ministria e Financave
	përfaqësuar nga

Korçë,
më 2012
KRWM
përfaqësuar nga

VENDIM

Nr. 92, datë 6.2.2013

PËR HAPJEN E PIKËS SË PËRBASHKËT TË KALIMIT NDËRKUFITAR NË TREBISHT TË RRETHIT TË BULQIZËS, NË KUFIRIN SHTETËROR TOKËSOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ME MAQEDONINË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr. 9861, datë 24.1.2008 “Për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Hapjen e pikës së përbashkët të kalimit ndërkufitar (lokale) në Trebisht të rrethit të Bulqizës, në kufirin shtetëror tokësor të Republikës së Shqipërisë me Maqedoninë, për qarkullim lokal të shtetasve dhe autoveturave.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve Publike dhe Transportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 93, datë 6.2.2013

PËR HAPJEN E PIKËS SË PËRBASHKËT TË KALIMIT KUFITAR NË GRABON TË RRETHIT TË MALËSISË SË MADHE DHE TË PIKËS SË KALIMIT NDËRKUFITAR NË ÇEREM TË RRETHIT TË TROPOJËS, NË KUFIRIN SHTETËROR TOKËSOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ME MALIN E ZI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 45/2012 “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi “Për përcaktimin e pikës së përbashkët të kalimit kufitar “Zatrijebacka Cijevna-Grabon”, për trafikun ndërkombëtar të pasagjerëve dhe pikën e kalimit kufitar “Çerem-Vranic”” dhe të nenit 15 të ligjit nr. 9861, datë 24.1.2008 “Për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e pikës së përbashkët të kalimit kufitar në Grabon të rrethit të Malësisë së Madhe, në kufirin shtetëror tokësor të Republikës së Shqipërisë me Malin e Zi, për qarkullimin ndërkombëtar të shtetasve dhe autoveturave.

2. Hapjen e pikës së kalimit ndërkufitar (lokale) në Çerem të rrethit të Tropojës, në kufirin shtetëror tokësor të Republikës së Shqipërisë me Malin e Zi, për qarkullimin lokal të shtetasve.

3. Ngarkohet Ministria e Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve Publike dhe Transporte për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 94, datë 6.2.2013

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS GOSË TË QARKUT TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Gosë të qarkut të Tiranës, sipas lidhjes nr. 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ të komunës Gosë të qarkut të Tiranës, miratuar me vendimin nr. 718, datë 30.10.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Gosë të qarkut të Tiranës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Gosë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Gosë

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-9	Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën arsimore	Në pronësi
10,12-14	Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën kulturore e sportive	Në pronësi
16-19	Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
20-24	Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën e mbrojtjes civile	Në pronësi
25,32-41,42	Infrastrukturë (rrugë vendore, sheshe, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
26-31	Varrezat publike	Në pronësi
59,63,65,66,68,155,158,161,164,166,168,171,175	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi



VENDIM
Nr. 95, datë 6.2.2013

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS KARINË TË QARKUT TË ELBASANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Karinë të qarkut të Elbasanit, sipas lidhjes nr. 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi. Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Karinë të qarkut të Elbasanit, miratuar me vendimin nr. 763, datë 28.5.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Karinë të qarkut të Elbasanit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Karinë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna: Karinë, Elbasan

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-8	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
9,10	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
11-27	Prona që përdoren për shërbime funerale	Në pronësi
247-256	Prona që përdoren për infrastrukturë dhe shërbime publike (troje)	Në përdorim
323-332,333-336,337	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim Nuk transferohen sipërfaqet e tokës bujqësore të trajtuara me VKM 868, datë 18.6.2008
332/1,366/1,337/1,344	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
32-244	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
245,246	Prona që përdoren për infrastrukturë dhe shërbime publike (sheshe)	Në pronësi
30-31	Prona që përdoren për zhvillim ekonomik	Në pronësi

VENDIM
Nr. 96, datë 6.2.2013

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E BRENDSHME, PËR PROGRAMIN E SHËRBIMIT TË GJENDJES CIVILE, PËR
MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË PRINTIMIT TË LISTAVE TË ZGJEDHËSVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Brendshme, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, në programin “Shërbimi i Gjendjes Civile”, në artikullin 602 “Mallra e shërbime të tjera”, t’i shtohet fondi prej 14 311 630 (katërmëdhjetë milionë e treqind e njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve të printimit të listave të zgjedhësve, në funksion të plotësimit të nevojave të Shërbimit të Gjendjes Civile me letër dhe toner për printer.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministri i Financave dhe Ministri i Brendshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



Lista e ZGjC-ve me sasinë e tonerave dhe sasinë e pakove me letra

NR	Qarku	Rrethi	Kodi	NJQV	Sasia e Tonerave	Sasia e pakove me letra (500 faqe)
1	Berat	BERAT	2	Bashkia Berat R1	2	12
2	Berat	BERAT	3	Bashkia Berat R2	2	12
3	Berat	BERAT	4	Bashkia Berat R3	2	11
4	Berat	BERAT	5	Bashkia Ura Vajguore	1	6
5	Berat	BERAT	6	Komuna Kutalli	2	7
6	Berat	BERAT	7	Komuna Lumas	1	4
7	Berat	BERAT	8	Komuna Otlak	2	7
8	Berat	BERAT	9	Komuna Poshnje	1	5
9	Berat	BERAT	10	Komuna Roshnik	1	2
10	Berat	BERAT	11	Komuna Sinje	1	3
11	Berat	BERAT	12	Komuna Terpan	1	2
12	Berat	BERAT	13	Komuna Velabisht	1	6
13	Berat	BERAT	14	Komuna Vertop	1	4
14	Berat	BERAT	15	Komuna Cukalat	1	3
15	Berat	KUÇOVE	17	Bashkia Kuçovë	3	16
16	Berat	KUÇOVE	18	Komuna Kozare	1	4
17	Berat	KUÇOVE	19	Komuna Perondi	1	6
18	Berat	SKRAPAR	21	Bashkia Çorovodë	1	4
19	Berat	SKRAPAR	22	Bashkia Poliçan	1	5
20	Berat	SKRAPAR	23	Komuna Bogovë	1	2
21	Berat	SKRAPAR	24	Komuna Cepan	1	1
22	Berat	SKRAPAR	25	Komuna Gjerbes	1	2
23	Berat	SKRAPAR	27	Komuna Potom	1	1
24	Berat	SKRAPAR	28	Komuna Qendër - SKRAPAR	1	3
25	Diber	DIBER	32	Bashkia Peshkopi	2	9
26	Diber	DIBER	33	Komuna Arras	1	2
27	Diber	DIBER	34	Komuna Fushë Cidhen	1	2
28	Diber	DIBER	35	Komuna Fushë Muhur	1	2
29	Diber	DIBER	36	Komuna Kala e Dodës	1	2
30	Diber	DIBER	37	Komuna Kastriot	1	4
31	Diber	DIBER	38	Komuna Lurë	1	1
32	Diber	DIBER	39	Komuna Luzni	1	2
33	Diber	DIBER	40	Komuna Maqellare	2	7
34	Diber	DIBER	41	Komuna Melan	1	3
35	Diber	DIBER	42	Komuna Tomin	1	4
36	Diber	DIBER	43	Komuna Selishtë	1	1
37	Diber	DIBER	44	Komuna Slllove	1	2
38	Diber	DIBER	45	Komuna Zall Dardhë	1	2
39	Diber	MAT	48	Bashkia Burrel	2	9
40	Diber	MAT	49	Bashkia Klos	1	5
41	Diber	MAT	50	Komuna Derjan	1	2
42	Diber	MAT	51	Komuna Gurre	1	2
43	Diber	MAT	52	Komuna Baz	1	2
44	Diber	MAT	53	Komuna Koms	1	3
45	Diber	MAT	54	Komuna Lis	1	3
46	Diber	MAT	56	Komuna Rukaj	1	2
47	Diber	MAT	57	Komuna Suç	1	2
48	Diber	MAT	58	Komuna Ulëz	1	1
49	Diber	MAT	59	Komuna Xibër	1	2
50	Diber	BULQIZE	61	Bashkia Bulqizë	1	6
51	Diber	BULQIZE	62	Komuna Gjoricë	1	3
52	Diber	BULQIZE	64	Komuna Martanesh	1	2

53	Diber	BULQIZE	65	Komuna Ostren	1	3
54	Diber	BULQIZE	66	Komuna Shupenzë	1	4
55	Diber	BULQIZE	67	Komuna Zerqan	1	3
56	Diber	BULQIZE	68	Komuna Fushë Bulqizë	1	2
57	Durres	DURRES	70	Bashkia Durrës R1	3	16
58	Durres	DURRES	71	Bashkia Durrës R2	3	16
59	Durres	DURRES	72	Bashkia Durrës R3	3	15
60	Durres	DURRES	73	Bashkia Durrës R4	5	26
61	Durres	DURRES	74	Bashkia Durrës R5	6	33
62	Durres	DURRES	75	Bashkia Manëz	1	6
63	Durres	DURRES	76	Bashkia Sukth	3	13
64	Durres	DURRES	77	Bashkia Shijak	2	7
65	Durres	DURRES	78	Komuna Gjejalaj	1	3
66	Durres	DURRES	79	Komuna Ishem	1	5
67	Durres	DURRES	80	Komuna Katund I ri	2	8
68	Durres	DURRES	81	Komuna Maminas	1	4
69	Durres	DURRES	82	Komuna Rashbull	3	14
70	Durres	DURRES	83	Komuna Xhafzotaj	2	9
71	Durres	KRUJE	85	Bashkia Kruje	2	9
72	Durres	KRUJE	86	Bashkia Fushe Kruje	2	12
73	Durres	KRUJE	87	Komuna Bubq	1	5
74	Durres	KRUJE	88	Komuna Cudhi	1	2
75	Durres	KRUJE	89	Komuna Kodër Thumanë	2	8
76	Durres	KRUJE	90	Komuna Nikel	1	5
77	Elbasan	ELBASAN	92	Bashkia Elbasan R1	2	12
78	Elbasan	ELBASAN	93	Bashkia Elbasan R2	2	12
79	Elbasan	ELBASAN	94	Bashkia Elbasan R3	3	13
80	Elbasan	ELBASAN	95	Bashkia Elbasan R4	2	12
81	Elbasan	ELBASAN	96	Bashkia Elbasan R5	3	17
82	Elbasan	ELBASAN	97	Bashkia Cërrik	2	8
83	Elbasan	ELBASAN	98	Bashkia Belsh	2	8
84	Elbasan	ELBASAN	99	Komuna Bradashesh	2	8
85	Elbasan	ELBASAN	100	Komuna Fierze	1	2
86	Elbasan	ELBASAN	101	Komuna Funarë	1	2
87	Elbasan	ELBASAN	102	Komuna Gostime	1	6
88	Elbasan	ELBASAN	104	Komuna Grekan	1	3
89	Elbasan	ELBASAN	105	Komuna Gjinar	1	4
90	Elbasan	ELBASAN	106	Komuna Gjergjan	1	4
91	Elbasan	ELBASAN	107	Komuna Kajan	1	4
92	Elbasan	ELBASAN	108	Komuna Klos	1	2
93	Elbasan	ELBASAN	109	Komuna Labinot mal	1	3
94	Elbasan	ELBASAN	110	Komuna Labinot fushë	1	3
95	Elbasan	ELBASAN	111	Komuna Mollas	1	4
96	Elbasan	ELBASAN	112	Komuna Paper	1	5
97	Elbasan	ELBASAN	114	Komuna Shalës	1	4
98	Elbasan	ELBASAN	115	Komuna Shirgjan	1	5
99	Elbasan	ELBASAN	116	Komuna Shushice	1	5
100	Elbasan	ELBASAN	117	Komuna Tregan	1	3
101	Elbasan	GRAMSH	120	Bashkia Gramsh	2	9
102	Elbasan	GRAMSH	121	Komuna Kodovjat	1	3
103	Elbasan	GRAMSH	122	Komuna Kukur	1	2
104	Elbasan	GRAMSH	125	Komuna Pishaj	1	5
105	Elbasan	GRAMSH	129	Komuna Tunje	1	2
106	Elbasan	PEQIN	131	Bashkia Peqin	1	6
107	Elbasan	PEQIN	133	Komuna Gjocaj	1	4
108	Elbasan	PEQIN	134	Komuna Pajove	1	5
109	Elbasan	PEQIN	135	Komuna Përparim	1	3
110	Elbasan	PEQIN	136	Komuna Shezë	1	3



111	Elbasan	LIBRAZHD	138	Bashkia Librazhd	1	6
112	Elbasan	LIBRAZHD	139	Bashkia Prenjas	1	5
113	Elbasan	LIBRAZHD	140	Komuna Hotolisht	1	4
114	Elbasan	LIBRAZHD	141	Komuna Lunik	1	2
115	Elbasan	LIBRAZHD	142	Komuna Orenje	1	3
116	Elbasan	LIBRAZHD	143	Komuna Polis	1	3
117	Elbasan	LIBRAZHD	144	Komuna Qendër - LIBRAZHD	1	6
118	Elbasan	LIBRAZHD	145	Komuna Qukës	1	5
119	Elbasan	LIBRAZHD	146	Komuna Rajce	1	5
120	Elbasan	LIBRAZHD	147	Komuna Stravaj	1	2
121	Fier	FIER	150	Bashkia Fier R1	2	10
122	Fier	FIER	151	Bashkia Fier R2	3	13
123	Fier	FIER	152	Bashkia Fier R3	3	13
124	Fier	FIER	153	Bashkia Fier R4	2	11
125	Fier	FIER	154	Bashkia Patos	3	16
126	Fier	FIER	155	Bashkia Roskovec	1	5
127	Fier	FIER	156	Komuna Cakran	2	8
128	Fier	FIER	157	Komuna Dermenas	2	7
129	Fier	FIER	158	Komuna Frakull	1	5
130	Fier	FIER	159	Komuna Kuman	1	4
131	Fier	FIER	160	Komuna Kurjan	1	3
132	Fier	FIER	161	Komuna Libofshë	1	6
133	Fier	FIER	162	Komuna Levan	2	9
134	Fier	FIER	163	Komuna Mbrostar	1	5
135	Fier	FIER	164	Komuna Portëz	1	6
136	Fier	FIER	165	Komuna Qendër - FIER	1	6
137	Fier	FIER	166	Komuna Ruzhdie	1	2
138	Fier	FIER	167	Komuna Strum	1	5
139	Fier	FIER	168	Komuna Topojë	1	4
140	Fier	FIER	169	Komuna Zharrëz	1	5
141	Fier	LUSHNJE	171	Bashkia Lushnjë R1	3	14
142	Fier	LUSHNJE	172	Bashkia Lushnjë R2	3	15
143	Fier	LUSHNJE	173	Bashkia Divjakë	2	7
144	Fier	LUSHNJE	174	Komuna Allkaj	1	4
145	Fier	LUSHNJE	175	Komuna Ballagat	1	2
146	Fier	LUSHNJE	176	Komuna Bubullimë	1	4
147	Fier	LUSHNJE	177	Komuna Dushk	1	6
148	Fier	LUSHNJE	178	Komuna Fier Shegan	1	5
149	Fier	LUSHNJE	179	Komuna Golem	1	4
150	Fier	LUSHNJE	180	Komuna Grabian	1	3
151	Fier	LUSHNJE	181	Komuna Gradisht	1	6
152	Fier	LUSHNJE	182	Komuna Hysgjokaj	1	2
153	Fier	LUSHNJE	183	Komuna Karbunarë	1	3
154	Fier	LUSHNJE	184	Komuna Kolonjë	1	5
155	Fier	LUSHNJE	185	Komuna Krutje	1	6
156	Fier	LUSHNJE	186	Komuna Remas	1	4
157	Fier	LUSHNJE	187	Komuna Tërbuf	2	8
158	Fier	MALLAKASTE	189	Bashkia Ballsh	2	7
159	Fier	MALLAKASTE	190	Komuna Aranitas	1	3
160	Fier	MALLAKASTE	191	Komuna Fratar	1	4
161	Fier	MALLAKASTE	192	Komuna Greshicë	1	1
162	Fier	MALLAKASTE	193	Komuna Hekal	1	3
163	Fier	MALLAKASTE	194	Komuna Kute	1	2
164	Fier	MALLAKASTE	196	Komuna Qender - MALLAKASTER	1	5
165	Gjirokaster	GJIROKASTER	199	Bashkia Gjirokastrë	3	18
166	Gjirokaster	GJIROKASTER	200	Bashkia Libohovë	1	4
167	Gjirokaster	GJIROKASTER	202	Komuna Cepo	1	4
168	Gjirokaster	GJIROKASTER	203	Komuna Dropull posht.	1	6

169	Gjirokaster	GJIROKASTER	204	Komuna Dropull sip.	2	7
170	Gjirokaster	GJIROKASTER	205	Komuna Lazarat	1	2
171	Gjirokaster	GJIROKASTER	206	Komuna Lunxheri	1	5
172	Gjirokaster	GJIROKASTER	209	Komuna Pogon	1	2
173	Gjirokaster	TEPELENE	213	Bashkia Tepelenë	1	5
174	Gjirokaster	TEPELENE	214	Bashkia Memaliaj	1	4
175	Gjirokaster	TEPELENE	216	Komuna F. Memaliaj	1	2
176	Gjirokaster	TEPELENE	217	Komuna Krahës	1	4
177	Gjirokaster	TEPELENE	220	Komuna Luftinjë	1	3
178	Gjirokaster	TEPELENE	222	Komuna Qendër - TEPELENE	1	5
179	Gjirokaster	PERMET	224	Bashkia Përmet	1	6
180	Gjirokaster	PERMET	225	Bashkia Këlcyre	1	3
181	Gjirokaster	PERMET	226	Komuna Ballaban	1	2
182	Gjirokaster	PERMET	227	Komuna Çarçove	1	2
183	Gjirokaster	PERMET	229	Komuna Petran	1	2
184	Gjirokaster	PERMET	230	Komuna Qendër - PERMET	1	3
185	Gjirokaster	PERMET	231	Komuna Suke	1	2
186	Gjirokaster	PERMET	232	Komuna Dishnicë	1	2
187	Korce	KORÇE	234	Bashkia Korçë	8	48
188	Korce	KORÇE	238	Bashkia Maliq	1	5
189	Korce	KORÇE	239	Komuna Drenovë	1	6
190	Korce	KORÇE	240	Komuna Gore	1	3
191	Korce	KORÇE	242	Komuna Libonik	2	7
192	Korce	KORÇE	243	Komuna Liqenas	1	3
193	Korce	KORÇE	245	Komuna Mollaj	1	5
194	Korce	KORÇE	246	Komuna Pirg	1	5
195	Korce	KORÇE	247	Komuna Pojan	2	9
196	Korce	KORÇE	248	Komuna Qendër - KORÇE	2	7
197	Korce	KORÇE	250	Komuna Voskop	1	3
198	Korce	KORÇE	251	Komuna Voskopojë	1	2
199	Korce	KORÇE	252	Komuna Vreshtas	1	6
200	Korce	KOLONJE	254	Bashkia Ersekë	1	4
201	Korce	KOLONJE	255	Bashkia Leskovik	1	3
202	Korce	KOLONJE	259	Komuna Mollas	1	3
203	Korce	KOLONJE	261	Komuna Qendër - Ersekë	1	3
204	Korce	POGRADEC	263	Bashkia Pogradec	4	20
205	Korce	POGRADEC	264	Komuna Bucimas	2	9
206	Korce	POGRADEC	265	Komuna Cerravë	1	5
207	Korce	POGRADEC	266	Komuna Dardhas	1	2
208	Korce	POGRADEC	267	Komuna Udenisht	1	4
209	Korce	POGRADEC	268	Komuna Proptisht	1	4
210	Korce	POGRADEC	269	Komuna Trebinjë	1	2
211	Korce	POGRADEC	270	Komuna Velcan	1	2
212	Korce	DEVOLL	272	Bashkia Bilisht	1	6
213	Korce	DEVOLL	273	Komuna Qendër - Bilisht	1	5
214	Korce	DEVOLL	274	Komuna Miras	1	6
215	Korce	DEVOLL	275	Komuna Hoçisht	1	4
216	Korce	DEVOLL	276	Komuna Progër	1	4
217	Kukes	KUKES	278	Bashkia Kukës	2	12
218	Kukes	KUKES	280	Komuna Bicaj	1	4
219	Kukes	KUKES	281	Komuna Bushtricë	1	2
220	Kukes	KUKES	282	Komuna Malzi	1	2
221	Kukes	KUKES	284	Komuna Tërthore	1	2
222	Kukes	KUKES	285	Komuna Shtiqen	1	2
223	Kukes	KUKES	286	Komuna Zapod	1	2
224	Kukes	KUKES	287	Komuna Shishtavec	1	3
225	Kukes	KUKES	288	Komuna Topojan	1	2
226	Kukes	KUKES	289	Komuna Surroj	1	2



227	Kukes	HAS	294	Bashkia Krumë	1	4
228	Kukes	HAS	295	Komuna Golaj	1	4
229	Kukes	HAS	296	Komuna Fajzë	1	2
230	Kukes	TROPOJE	299	Bashkia B. Curri	1	5
231	Kukes	TROPOJE	300	Komuna Bujan	1	2
232	Kukes	TROPOJE	301	Komuna Bytyc	1	1
233	Kukes	TROPOJE	302	Komuna Fierzë	1	2
234	Kukes	TROPOJE	303	Komuna Lekbibaj	1	1
235	Kukes	TROPOJE	304	Komuna Llugaj	1	2
236	Kukes	TROPOJE	305	Komuna Margegaj	1	2
237	Kukes	TROPOJE	306	Komuna Tropojë	1	3
238	Lezhe	LEZHE	308	Bashkia Lezhë	3	15
239	Lezhe	LEZHE	309	Komuna Balldre	1	6
240	Lezhe	LEZHE	310	Komuna Blinisht	1	3
241	Lezhe	LEZHE	311	Komuna Dajç	1	4
242	Lezhe	LEZHE	312	Komuna Kallmet	1	4
243	Lezhe	LEZHE	313	Komuna Kolsh	1	4
244	Lezhe	LEZHE	314	Komuna Shëngjin	1	6
245	Lezhe	LEZHE	315	Komuna Ungrej	1	2
246	Lezhe	LEZHE	316	Komuna Shënkoll	2	8
247	Lezhe	LEZHE	317	Komuna Zejmen	1	5
248	Lezhe	MIRDITE	319	Bashkia Rrëshen	2	8
249	Lezhe	MIRDITE	320	Bashkia Rubik	1	4
250	Lezhe	MIRDITE	321	Komuna Fan	1	3
251	Lezhe	MIRDITE	323	Komuna Kthellë	1	3
252	Lezhe	MIRDITE	324	Komuna Orosh	1	2
253	Lezhe	KURBIN	327	Bashkia Laç	3	15
254	Lezhe	KURBIN	328	Bashkia Mamurras	2	11
255	Lezhe	KURBIN	329	Komuna Fushë Kuqe	1	5
256	Lezhe	KURBIN	330	Komuna Milot	1	6
257	Shkoder	SHKODER	332	Bashkia Shkodër	10	58
258	Shkoder	SHKODER	336	Bashkia Vau Dejes	2	8
259	Shkoder	SHKODER	337	Komuna Ana Malit	1	3
260	Shkoder	SHKODER	338	Komuna Bushat	2	12
261	Shkoder	SHKODER	340	Komuna Berdicë	1	5
262	Shkoder	SHKODER	341	Komuna Dajç	1	5
263	Shkoder	SHKODER	342	Komuna Gur i zi	1	6
264	Shkoder	SHKODER	343	Komuna Hajmel	1	5
265	Shkoder	SHKODER	344	Komuna Postirbë	1	6
266	Shkoder	SHKODER	345	Komuna Pult	1	2
267	Shkoder	SHKODER	346	Komuna Rrethinat	2	11
268	Shkoder	SHKODER	347	Komuna Shalë	1	3
269	Shkoder	SHKODER	350	Komuna Velipojë	1	5
270	Shkoder	SHKODER	352	Komuna Shllak	1	1
271	Shkoder	PUKE	354	Bashkia Pukë	1	5
272	Shkoder	PUKE	355	Bashkia Fushë Arrëz	1	4
273	Shkoder	PUKE	357	Komuna Iballë	1	1
274	Shkoder	PUKE	358	Komuna Fierzë	1	1
275	Shkoder	PUKE	359	Komuna Gjegjan	1	3
276	Shkoder	PUKE	362	Komuna Qerret	1	2
277	Shkoder	MALESI E MAD	365	Bashkia Koplik	1	6
278	Shkoder	MALESI E MAD	366	Komuna Gruemirë	2	7
279	Shkoder	MALESI E MAD	367	Komuna Kastrat	2	7
280	Shkoder	MALESI E MAD	368	Komuna Kelmend	1	4
281	Shkoder	MALESI E MAD	369	Komuna Qendër - MALESI E MADHE	1	3
282	Shkoder	MALESI E MAD	370	Komuna Shkrel	1	3
283	Tirane	TIRANE	373	Bashkia Tiranë - Njësia Bashkiake Nr.	5	26
284	Tirane	TIRANE	374	Bashkia Tiranë - Njësia Bashkiake Nr.	7	40

285	Tirane	TIRANE	375	Bashkia Tiranë - Njësia Bashkiake Nr. 1	4	24
286	Tirane	TIRANE	376	Bashkia Tiranë - Njësia Bashkiake Nr. 2	6	32
287	Tirane	TIRANE	377	Bashkia Tiranë - Njësia Bashkiake Nr. 3	8	43
288	Tirane	TIRANE	378	Bashkia Tiranë - Njësia Bashkiake Nr. 4	6	32
289	Tirane	TIRANE	379	Bashkia Tiranë - Njësia Bashkiake Nr. 5	6	36
290	Tirane	TIRANE	380	Bashkia Tiranë - Njësia Bashkiake Nr. 6	4	22
291	Tirane	TIRANE	381	Bashkia Tiranë - Njësia Bashkiake Nr. 7	6	31
292	Tirane	TIRANE	382	Bashkia Tiranë - Njësia Bashkiake Nr. 8	3	16
293	Tirane	TIRANE	383	Bashkia Tiranë - Njësia Bashkiake Nr. 9	6	32
294	Tirane	TIRANE	384	Bashkia Kamëz	7	39
295	Tirane	TIRANE	386	Bashkia Vorë	2	10
296	Tirane	TIRANE	387	Komuna Baldushk	1	3
297	Tirane	TIRANE	388	Komuna Bërzhitë	1	3
298	Tirane	TIRANE	389	Komuna Bërçull	1	5
299	Tirane	TIRANE	390	Komuna Dajt	2	7
300	Tirane	TIRANE	391	Komuna Farkë	1	6
301	Tirane	TIRANE	392	Komuna Kashar	2	11
302	Tirane	TIRANE	393	Komuna Ndroq	1	5
303	Tirane	TIRANE	394	Komuna Paskuqan	4	19
304	Tirane	TIRANE	395	Komuna Petrelë	1	4
305	Tirane	TIRANE	396	Komuna Pezë	1	3
306	Tirane	TIRANE	397	Komuna Prezë	1	4
307	Tirane	TIRANE	398	Komuna Shengjergj	1	2
308	Tirane	TIRANE	399	Komuna Vaqarr	1	5
309	Tirane	TIRANE	400	Komuna Zall Bastar	1	3
310	Tirane	TIRANE	401	Komuna Zall Herr	1	5
311	Tirane	TIRANE	402	Komuna Krrabë	1	2
312	Tirane	KAVAJE	404	Bashkia Kavajë	4	20
313	Tirane	KAVAJE	405	Bashkia Rrogozhinë	2	7
314	Tirane	KAVAJE	406	Komuna Golem	1	6
315	Tirane	KAVAJE	407	Komuna Gose	1	4
316	Tirane	KAVAJE	408	Komuna Helmes	1	3
317	Tirane	KAVAJE	409	Komuna Kryevindh	1	5
318	Tirane	KAVAJE	410	Komuna Lekaj	1	5
319	Tirane	KAVAJE	411	Komuna Luz i vogël	1	5
320	Tirane	KAVAJE	413	Komuna Synej	1	6
321	Vlore	VLORE	415	Bashkia Vlorë R1	3	13
322	Vlore	VLORE	416	Bashkia Vlorë R2	3	15
323	Vlore	VLORE	417	Bashkia Vlorë R3	3	15
324	Vlore	VLORE	418	Bashkia Vlorë R4	3	15
325	Vlore	VLORE	419	Bashkia Vlorë R5	3	15
326	Vlore	VLORE	420	Bashkia Himarë	2	8
327	Vlore	VLORE	421	Bashkia Orikum	1	6
328	Vlore	VLORE	422	Bashkia Selenicë	1	4
329	Vlore	VLORE	423	Komuna Armeni	1	4
330	Vlore	VLORE	424	Komuna Brataj	1	3
331	Vlore	VLORE	425	Komuna Hore Vranisht	1	3
332	Vlore	VLORE	426	Komuna Kotë	1	4
333	Vlore	VLORE	427	Komuna Novoselë	2	9
334	Vlore	VLORE	428	Komuna Qendër - VLORE	2	10
335	Vlore	VLORE	429	Komuna Sevaster	1	2
336	Vlore	VLORE	430	Komuna Shushicë	1	5
337	Vlore	VLORE	431	Komuna Vllahinë	1	4
338	Vlore	SARANDE	433	Bashkia Sarandë	4	22
339	Vlore	SARANDE	434	Bashkia Konispol	1	2
340	Vlore	SARANDE	435	Komuna Aliko	1	5
341	Vlore	SARANDE	436	Komuna Dhivër (1)	1	4
342	Vlore	SARANDE	438	Komuna Ksamil	1	5
343	Vlore	SARANDE	439	Komuna Livadhja	1	6
344	Vlore	SARANDE	440	Komuna Lukovë	1	6
345	Vlore	SARANDE	441	Komuna Markat	1	2
346	Vlore	SARANDE	442	Komuna Xarrë	1	4
347	Vlore	DELVINE	444	Bashkia Delvinë	2	8
348	Vlore	DELVINE	445	Komuna Finiq	1	4
349	Vlore	DELVINE	446	Komuna Mesopotam	1	4
350	Vlore	DELVINE	447	Komuna Vergo	1	3
					536	2,321



VENDIM
Nr. 97, datë 6.2.2013

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 484, DATË 23.6.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË BORDIT TË MENAXHIMIT PËR
AUTORITETIN RRUGOR SHQIPTAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 8 të ligjit nr. 10 164, datë 15.10.2009 “Për Autoritetin Rrugor Shqiptar”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në shkronjën “b” të pikës 1 të vendimit nr. 484, datë 23.6.2010 të Këshillit të Ministrave, fjalët “Z . Egon Babameto” zëvendësohen me “Z. Eduart Seitaj”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 100, datë 6.2.2013

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR “URA E RE E BUNËS (SHTESAT)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Ura e re e Bunës (shtesat)”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqe trualli prej 2 765 (dy mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë) m², me vlerë 41 475 000 (dyzet e një milionë e katërqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë, për kullotë, me sipërfaqe 295 (dyqind e nëntëdhjetë e pesë) m², me vlerë 56 935 (pesëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e tridhjetë e pesë) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 41 531 935 (dyzet e një milionë e pesëqind e tridhjetë e një mijë e nëntëqind e tridhjetë e pesë) lekësh.

4. Shpenzimet procedurale në vlerën 284 000 (dyqind e tetëdhjetë e katër mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

5. Vlëra e përgjithshme e shpronësimit prej 41 531 935 (dyzet e një milionë e pesëqind e tridhjetë e një mijë e nëntëqind e tridhjetë e pesë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2013, zëri “Shpronësime”, miratuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

6. Shpronësimi të fillojë nga data 28.2.2013.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP-ja”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të dorëzojnë dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimin e pronarëve, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP-ja” pasi të kenë dorëzuar dokumentacionin e plotë të pronësisë.

9. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Shkodër, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t’u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Shkodër, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Shkodër, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE
LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË SEGMENTIT RRUGOR
URA E RE E BUNËS

Qarku Shkodër

Nr.	Emri, mbiemri	Z.K.	Nr. pas.	Kullotë			Truall			Vlera totale lekë	Shënime
				Sip.m ²	Çmimi m ²	Vlera në lekë	Sip.m ²	Çmimi m ²	Vlera në lekë		
1	Hasan Ali Isufi	8591	19/232				2716	15000	40740000	40740000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
2	Vehbi Zejnun Gjuhca	8591	19/229	295	193	56935				56935	Konfirmuar nga ZRPP-ja
3	Benjamin Pjerin Daberdaku	8591	18/112				49	15000	735000	735000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
	Shuma lekë			295			2765			41531935	

VENDIM
Nr. 101, datë 6.2.2013

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 424, DATË 2.6.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR SISTEMIN E AKREDITIMIT, ORGANIZIMIN DHE VEPRIMTARINË E INSTITUCIONEVE TË SIGURIMIT TË JASHTËM TË CILËSISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 60 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

Pas pikës 3 të nenit 9/2 të rregullores “Për sistemin e akreditimit, organizimit dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë”, që i bashkëlidhet vendimit nr. 424, datë 2.6.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Për vlerësimin e jashtëm të programit të studimit të ciklit të parë dhe të dytë, në grupin e vlerësimit të jashtëm të përfshihen ekspertë vendas ose të huaj. Për vlerësimin e jashtëm të shkollës së doktoratës në grupin e vlerësimit të jashtëm të jetë, së paku, një ekspert i huaj. Studimet e ciklit të tretë vlerësohen dhe akreditohen si shkollë e doktoratës në nivel institucioni ose njësie bazë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 103, datë 6.2.2013

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË KURIMIT TË
ZNJ. MESILA DODA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, zëri “Mallra dhe shërbime”, t’i shtohet fondi prej 1 100 000 (një milion e njëqind mijë) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve të kurimit të znj. Mesila Doda.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të kurimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr. 1, datë 7.2.2013

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 1457, DATË 28.7.2009 “PËR
PROCEDURËN E SHQYRTIMIT TË KËRKESAVE PËR LICENCIM, TË SUBJEKTEVE
QË KRYEJNË VEPRIMTARI TË FORMIMIT PROFESIONAL”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 8 dhe nenit 23 shkronja “c” të ligjit nr. 8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 20 të ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” dhe të pikës 5 kreu II dhe pikës 4 kreu XI të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregulla të tjera nënligjore të përbashkëta” të Këshillit të Ministrave

UDHËZOJ:

1. Përmbajtja e pikës 3 të udhëzimit nr. 1457, datë 28.7.2009 “Për procedurën e shqyrtimit të kërkesave për licencim, të subjekteve që kryejnë veprimtari të formimit profesional”, të ndryshuar, ndryshon si më poshtë:

“3. Shërbimi Kombëtar i Punësimit:

1. Shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, i cili përfshin dokumentet provuese sipas aneksit 1 fusha X kategoria X.2.B, bashkëngjitur vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregulla të tjera nënligjore të përbashkëta” të Këshillit të Ministrave dhe dokumentet provuese që lidhen me drejtuesin teknik, sipas përcaktimit të germës “a” pika 4 kreu III të këtij vendimi.

2. Bën inspektimin në vend të shërbimit që ofron subjekti, inspektim, i cili konsiston në plotësimin e standardeve lidhur me:

a) Përshtatshmërinë e ambientit

Sipërfaqja minimale për çdo vend pune/kursant të jetë 3-5 m² (në funksion të specialitetit të kursit), të ekzistojë baza materiale e nevojshme dhe kushtet higjieno-sanitare të përshtatshme.

b) Aftësitë teknike të instruktorit

Instruktori të ketë diplomë ose certifikatë për profesionin që do të ofrojë, nivel arsimor të paktën të mesëm, si dhe eksperiencë pune minimalisht 5 vjet, në profesionin për të cilin ofrohet formimi.

c) Përshtatshmërinë e programit të trajnimit

Programi i trajnimit të jetë i detajuar në orë, me module të veçanta, ku të jetë përcaktuar qartë raporti teori/praktikë.

d) Dokumentacionin e plotësuar për kursantin, i cili përfshin:

i) Librin e amzës, me numrin përkatës për çdo kursant;

ii) Regjistrin mësimor;

iii) Mandate arkëtimi për pagesën e kursit.

e) Pajisjen e kursantit me certifikatën përkatëse pas përfundimit të kursit.

Certifikata duhet të ketë këto elemente të domosdoshme:

- Emërtimi (certifikatë);

- Nr. amze (referuar librit të amzës);

- Emri i subjektit sipas emërimit në licencën e QKL-së;

- Foto e kursantit e prekur nga vula e subjektit;

- Teksti të përmbajtje të dhënat e shënuara në librin e amzës;



- Numri i plotë i licencës dhe data e licencimit, dhënë nga QKL-ja;
 - Emri i administratorit, firma dhe vula e subjektit.
2. Në rreshtin e dytë të pikës 16, pas fjalës “e kërkuara” të shtohet togfjalëshi “në pikën 3 të këtij udhëzimi”.
- Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE
SHANSEVE TË BARABARTA
Spiro Ksera

URDHËR
Nr. 9, datë 13.2.2013

**PËR REVOKIMIN E URDHËRIT TË MINISTRIT TË FINANCAVE NR. 6, DATË 25.11.2005
“PËR SEKUESTRIMIN E ASETEVE TË SHTETASIT JORDANEZ ABDUL LATIF SALEH,
I NJOHUR EDHE SI: A) ABDYL LATIF A.A.SALEH, B) ABDYL LATIF SALEH, C) DR.
ABD AL-LATIF SALEH, D) ABDYL LATIF A.A.SALEH ABU HUSSEIN, E) ABD AL-
LATIF SALIH, F) ABU AMIR”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të ligjit nr. 9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ligjit nr. 8865, datë 14.3.2002 “Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për Luftën kundër Financimit të Terrorizmit e vitit 1999”, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 86, datë 7.2.2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004 të Këshillit të Ministrave “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit””, të ndryshuar

URDHËROJ:

1. Revokimin e urdhrit nr. 6, datë 25.11.2005 “Për sekuestrimin e asetëve të shtetasit jordanëz Abdul Latif Saleh, i njohur edhe si: a) Abdyl Latif A.A.Saleh, b) Abdyl Latif Saleh, c) Dr. Abd Al-Latif Saleh, d) Abdyl Latif A.A.Saleh Abu Hussein, e) Abd Al-Latif Salih, f) Abu Amir” të Ministrit të Financave, të ndryshuar me urdhrat nr. 22, datë 13.6.2006 dhe nr. 28, datë 5.7.2006.
2. Ky revokim përfshin të gjitha fondet, llogaritë, asetet, pasuritë e paluajtshme, trojet, investimet në shoqëri tregtare dhe mjetet financiare në emër të shtetasit Abdul Latif Saleh, i njohur edhe si: a) Abdyl Latif A.A.Saleh; b) Abdyl Latif Saleh; c) Dr. Abd Al-Latif Saleh; d) Abdyl Latif A.A.Saleh Abu Hussein; e) Abd Al-Latif Salih; f) Abu Amir”, të sekuestruara me urdhrat e mësipërm.
3. Për dorëzimin e pasurive të revokuara me këtë urdhër, të ngrihet një grup pune në përbërje të të cilit të ketë një përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave.
4. Ngarkohet Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara për kthimin e pasurive të identifikuar dhe të marra në dorëzim, si dhe të ardhurave të siguruar nga administrimi i tyre, pasi t’i zbriten shpenzimet e lejuara.
5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

VENDIM
Nr. 17, datë 31.1.2013

**MBI SHTYRJEN E ANKANDIT VJETOR TË KAPACITETEVE TË INTERKONJEKSIONIT
PËR VITIN 2013**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “ç” paragrafi “ii” dhe 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës 7 germa “b” të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 924, datë 26 dhjetor “Mbi lejimin e shoqërisë KESH sh.a., të importojë energji elektrike për periudhën 1.1.2013 deri 1.3.2013 për furnizimin e konsumatorëve tariforë dhe mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 31.1.2013, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

VENDOSI:

1. OST sh.a. të shtyjë zhvillimin e ankandit vjetor për kapacitetet ndërkufitare të interkonjeksionit për vitin 2013, në drejtim importi, deri në datën 22.2.2013.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 18, datë 11.2.2013

**PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLAT E TREGUT SHQIPTAR TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 54 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neni 112 pika 2 germa “a” të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.2.2013, pasi shqyrtoi propozimin e drejtorive teknike për një ndryshim në Rregullat e Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike,

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit 179, datë 28.12.2012 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, ndryshohet si më poshtë:

“Vendimi nr. 93, datë 16.7.2012, do t’i shtrijë efektet deri më 31 mars 2013.”

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë subjektet e interesuara për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 19, datë 11.2.2013

**PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES PËR HECET “VERBA 1” DHE
“VERBA 2” TË SHOQËRISË “HYDRO POWER PLANT OF KORCA” SHPK SI BURIM I
RINOVUESHËM ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “ll”, 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 6, 7 dhe 9, pikat 1 dhe 2 germa “a” të Rregullave dhe Procedurave të Certifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.2.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Hydro Power Plant of Korca” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për hec-et “Verba 1” dhe “Verba 2”, si burim i rinovueshëm energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “Hydro Power Plant of Korca” sh.p.k., është konform Rregullave dhe Procedurave të Certifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, si më poshtë:

- Neni 7 pika 1 gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Është plotësuar tërësisht.

- Neni 7 pika 2 gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Është plotësuar tërësisht.

- Neni 7 pika 4 gjerat “a”, “b”, “c”

Është plotësuar tërësisht.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kualifikimin e impiantit prodhues për hecet “Verba 1” dhe “Verba 2” të shoqërisë “Hydro Power Plant of Korca” sh.p.k., si burime të rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 20, datë 11.2.2013

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT PËR
MODIFIKIMIN E LICENCËS ME NR. 10, SERIA PV03P PËR PRODHIMIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA HEC "BICAJ" ME FUQI 100 KW TË SHOQËRISË "EN.KU" SHPK**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa "ll", 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 18 pika 1 germa "d" të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009 dhe neneve 7 dhe 8 të Rregullave dhe Procedurave të Certifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve në mbledhjen e tij të datës 11.2.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "EN.KU" sh.p.k. për fillimin e modifikimit të Licencës "Për prodhimin e energjisë elektrike nga hec "Bicaj"",

konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria "EN.KU" sh.p.k., është konform Rregullave dhe Procedurave të Certifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme, si më poshtë:

- Neni 7 pika 1 gjerat "a", "b", "c", "d"

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7 pika 2 gjerat "a", "b", "c", "d"

Dokumentacioni vijues grafik, koreografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

- Neni 7 pika 3 gjerat "a", "b", "c"

Përshkrimi i centralit...

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit për modifikimin e licencës me nr. 10, seria PV03P për prodhimin e energjisë elektrike nga hec "Bicaj" me fuqi 100 KW të shoqërisë "EN.KU" sh.p.k.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani



VENDIM
Nr. 16, datë 18.1.2013

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR
“TOP GOLD”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit për rinovimin e licencës dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik privat vendor “Top Gold”, në fushën e transmetimeve radiofonike private vendore.
 2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
- Ky vendim i shtrin efektet që nga data 9.11.2012 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endirë Bushati

VENDIM
Nr. 26, datë 18.1.2013

MBI VLEFSHMËRINË E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV KABLLOR
“TV ME KABËLL MEMALIAJ”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endirë Bushati	kryetar
Sami Nezaj	zëvendëskryetar
Gent Ibrahim	anëtar
Suela Musta	anëtare
Zylyftar Bregu	anëtar,

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Mbi vlefshmërinë e licencës së subjektit televiziv privat kabllor “TV me kabëll Memaliaj”.

BAZA LIGJORE: neni 7 pika 21, neni 33 pika 1 dhe 5 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VËREN SE:

KKRT-ja, me vendimin nr. 540, datë 4.12.2006, ka vendosur të licencojë subjektin, person fizik, Vladimir Shehu, për subjektin televiziv privat kabllor “TV me kabëll Memaliaj”, për të mbuluar me sinjal televiziv qytetin Memaliaj. Afati i licencës së subjektit ka përfunduar në datën 22.12.2012.

KKRT-ja, me shkresën nr. 1392 prot., datë 12.10.2012, ka njoftuar subjektin për përfundimin e afatit të licencës, duke kërkuar nga ky i fundit depozitimin e aplikimit për rinovim

licence. Pavarësisht njoftimit zyrtar të KKRT-së, nga ana e subjektit nuk është depozituar aplikim për rinovimin e licencës.

KKRT-ja konstaton se subjekti, përveç mungesës së interesit për rilicencim, ka detyrime financiare ndaj KKRT-së, pagesë vjetore për licencë për vitet 2010, 2011 dhe 2012, në masën 500.000 lekë.

Kështu, KKRT-ja me shkresat nr. 269 prot., datë 15.2.2010, nr. 64 prot., datë 14.1.2011, nr. 643 prot., datë 5.4.2011, nr. 704 prot., datë 14.4.2011 dhe nr. 196/35 prot., datë 2.2.2012, ka njoftuar zyrtarisht subjektin televiziv kabllor “TV me kabëll Memaliaj”, por pavarësisht këtyre njoftimeve subjekti vazhdon të jetë debitor ndaj KKRT-së në masën 500.000 lekë.

Më tej, me shkresat nr. 765 prot., datë 5.6.2012 dhe nr. 1056 prot., datë 13.7.2012, i është ripërsëritur kërkesa për kryerjen e pagesave, duke u paralajmëruar se në rast të mosshlyerjes së detyrimeve, nga ana e KKRT-së, do të ndiqen procedurat për bërjen të pavlefshme të licencës së subjektit.

Neni 33 i ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon se: “Licenca bëhet e pavlefshme kur:

1. Mbaron afati i vlefshmërisë dhe ajo nuk është rinovuar;

...

5. Kërkuesi ... nuk realizon detyrimet financiare të parashikuara me ligj pas 90 ditëve nga momenti kur merr dënimin zyrtarisht për miratimin e saj”.

Në mbështetje të nenit 137/3 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, KKRT-ja për t’i dhënë mundësi të licencuarit të japë mendime, para marrjes së vendimit për heqjen e licencës, njofton të licencuarin për vendimmarrjen përkatëse.

Në përfundim, KKRT-ja është e mendimit që subjektin televiziv privat kabllor “TV me kabëll Memaliaj”, t’i lihet një afat 30-ditor brenda të cilit të paraqesë pretendimet e tij lidhur me këtë vendim.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7 pika 21, nenit 33 pika 5 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të bëjë të pavlefshme licencën nr. 048/ RTV kabllor të subjektit televiziv privat kabllor “TV me kabëll Memaliaj”.

2. Subjekti sipas pikës 1 të ndërpresë menjëherë transmetimin.

3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për zbatimin e këtij vendimi.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditësh nga marrja dënimin, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endirë Bushati



VENDIM
Nr. 36, datë 1.2.2013

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN PRIVAT KABLLOR
“TV NEXT KABËLL”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, miratuar me vendimin nr. 221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010, vendimit të KKRT-së, nr. 160, datë 30.11.2012 “Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë radiotelevizivë kabllorë”, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit për t’u licencuar si operator privat kabllor dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë licencë subjektit fizik, z. Ervis Beqiri, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për “TV Next Kabëll”, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal bashkinë Kamëz.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen: struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endirë Bushati

VENDIM
Nr. 37, datë 1.2.2013

PËR ZGJERIM ZONE LICENCIMI PËR RADION VENDORE PRIVATE
“RADIO DURRËSI”
SUBJEKTIT: “RADIO DURRËSI” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor”, miratuar me vendimin nr. 355 pika 2, datë 29.8.2005 rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor”, miratuar me vendimin nr. 355 pika 1, datë 29.8.2005, rregullores “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010 të KKRT-së, frekuencave të lira të shpallura në mënyrë publike në mbështetje të vendimit nr. 161, datë 30.11.2012 “Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë privatë vendorë radiofonikë”, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit, dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të miratojë zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit “Radio Durrësi” sh.p.k., për radion vendore private “Radio Durrësi”, sipas licencës nr. 087/FML, në Rrethin Tiranë, në pikën transmetuese Fushë-Dajt, frekuenca 91.1 MHz.

2. Karakteristikat teknike janë pjesë e licencës përkatëse dhe u nënshtrohen të gjitha kushteve të saj.

3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për pasqyrimin e ndryshimeve përkatëse në licencën e subjektit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endirë Bushati

VENDIM
Nr. 38, datë 1.2.2013

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR
“RADIO ALPO”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit për rinovimin e licencës dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik vendor privat “Radio Alpo”, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore analoge.

2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.

Ky vendim i shtrin efektet që nga data 3.1.2013 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endirë Bushati

VENDIM
Nr. 39, datë 1.2.2013

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR
“RADIO NACIONAL”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit për rinovimin e licencës dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik vendor privat “Radio Nacional”, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore analoge.

2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 5.2.2013 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endirë Bushati

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 26.2.2013
Doli nga shtypi më 27.2.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 34 lekë